“Ai që lufton me qëllim që fjala e Allahut të jetë më e larta, i tilli është në rrugën e Allahut.”

Ebu Musa (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "I Dërguari i Allahut u pyet për atë që lufton për të treguar trimëri, atë që lufton për fanatizëm fisnor, atë që lufton për syefaqësi, se cili prej këtyre është në rrugën e Allahut, e atëherë i Dërguari i Allahut tha: “Ai që lufton me qëllim që fjala e Allahut të jetë më e larta, i tilli është në rrugën e Allahut.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti u pyet për qëllimet e ndryshme të atyre që luftojnë: dikush për trimëri, tjetri për fanatizëm fisnor e i treti për të dëshmuar se është dikushi ndër njerëz e qëllime të tjera. Cili prej tyre është në rrugë të Allahut? Kështu, Profeti tregoi se luftëtar i vërtetë në rrugë të Allahut është ai që lufton që fjala e Allahut të jetë më e larta.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/2969